

V E N D I M
Nr.507, datë 8.11.1999

PËR MIRATIMIN E AMENDAMENTIT TË MARRËVESHJES PËR KREDI ZHVILLIMI -
IDA CREDIT 2795 - ALB, PËR PROJEKTIN E AGROPËRPUNIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8371, datë 29.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Ministrisë së Financave,

KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D O S I:

1. Miratimin e shtyrjes së datës të mbylljes së marrëveshjes të kredisë ndërmjet Shqipërisë dhe IDA-s, për projektin e agropërpunimit, deri më 30 qershor 2000, vetëm për financimin e sektorit të agropërpunimit.

2. Miratimin e uljes së fondeve në zërin "Shërbime konsulence, udhëtime studimi e trajnimi për projektin" nga 70 000 SDR në 60 000 SDR dhe futjen e një zëri të ri "Shpenzime operative në rritje" prej 10 000 SDR-sh.

3. Miratimin e mbylljes së njësisë së zbatimit të projektit të agropërpunimit pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, më datën 8 nëntor 1999.

4. Ngarkohet njësia e zbatimit të projekteve pranë Ministrisë së Financave, për administrimin e fondeve të projektit të agropërpunimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta